

# **STATUTI**

**Dhe**

## **AKTI I THEMELIMIT**

**I**

### **SHOQERISE TREGTARE**

**"EKO-GREEN"**

#### **KREU I**

#### **EMERTIMI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

##### **Neni 1**

##### **Emri, perkufizime dhe Ortaket**

- 1.1 Me date 24 Qershor 2021 ne mbështetje te legjislacionit shqiptar ne fuqi, ne Ortaket e Shoqerise, kemi miratuar kete Statut te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EKO-GREEN" SHPK
- 1.2 Ortaket e Shoqerise jane:

Kolë Malaj, i datëlindjes 17-11-1958, lindur ne Lekbibaj Tropoje, me banim ne Tirane.

Deni Deda, i datëlindjes 02-05-2003, lindur dhe banues ne Lezhe

##### **Neni 2**

##### **Objekti**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EKO-GREEN" SHPK do te zhvilloje aktivitet si me poshte:

Akuakulturë,  
Mbarështimi i Faunës dhe Florës se egër,  
Agroturizm

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EKO-GREEN" sh.p.k zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi.

##### **Neni 3**

---

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EKO-GREEN SHPK"**





## **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar. Ajo mund te prishet ne cdo moment, sipas vendimeve te marra nga Asambleja e Pergjithshme

### **Neni 4 Selia**

- 4.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Lagjia "Gurra", Rruga "Kole Toma" Lezhe Shqiperi.
- 4.2 Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj. Per kete, ajo mund te hape dhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 5 Kapitali Themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke.
- 5.2 Pjesemarrja e Ortakeve ne kapitalin e Shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre si me poshte:
  - i. Z. Kolë Malaj, lindur me 17-11-1958, ne Lekbibaj Tropoje, Shqiperi, shtetas shqiptar mbajtes i Leternjoftimit nr. 031744519, i cili zoteron 1 (nje) kuote ne vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhjete mije) Lek, qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise.
  - ii. Deni Deda, lindur me 02-05-2003 ne Lezhe Shqiperi, shtetas shqiptar, mbajtes i Pasaportes Nr. BA929567S, i cili zoteron 1 (nje) kuote ne vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhjete mije) Lek, qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise.
- 5.3 Kontributet e Ortakeve si mesiper jane paguar ne vleren e tyre ne Lek.

### **Neni 6 Transferimi i Kapitalit**

- 6.1 Kuotat e kapitalit te Shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te transferohen ne perputhje me dispozitat e Ligjit.
- 6.2 Transferimi i kuotave te kapitalit ne favor te personave te trete kushtezohet nga e drejta e parablerjes se Ortakeve, ne proporcion me perqindjen e kapitalit qe zoterojne.



## **Neni 7** **Certifikata e kuotave te kapitalit**

Shoqeria mund te leshoje nje certifikate per te vertetuar zoterimin e kuotes se kapitalit. Kjo certifikate leshohet ne emer te personit apo te personave, qe zoterojne kuoten dhe nuk perben leter me vlere.

## **KREU III** **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

### **Neni 8** **Vendimet e Asamblese se Pergjithshme**

- 8.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organ vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga Ortaket e saj.
- 8.2 Ne perputhje me ligjin, Asambleja e Pergjithshme merr vendime:
  - a. Me shumice te zakonshme
  - b. Me shumice te kualifikuar
- 8.3 Per vendimet qe kerkojne shumice te zakonshme, ne mbledhje duhet te jene te pranishem Ortaket me te drejte vote, te cilet se bashku, zoterojne me shume se 30% te kapitalit te Shoqerise dhe vendimet merren me 50%+1 te votave te Ortakeve pjesemarres, me te drejte vote.
- 8.4 Per vendimet qe kerkojne shumice te kualifikuar, ne mbledhje duhet te jene te pranishem Ortaket me te drejte vote, te cilet se bashku, zoterojne me shume se 50% te kapitalit te Shoqerise dhe vendimet merren me 75%+1 te votave te Ortakeve pjesemarres, me te drejte vote.
- 8.5 Asambleja e Pergjithshme merr vendime me shumice te kualifikuar per:
  - Ndryshimet e Statutit.
  - Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
  - Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
  - Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise
  - Shperndarjen e fitimeve
  - Shitblerje te asetave te Shoqerise.
  - Shitblerje te pasurise se paluajtshme te Shoqerise.
  - Vendosjen e pengut e barreve hipotekore mbi pasurite e Shoqerise.
  - Marrje ose dhenie kredie ne emer te Shoqerise.
- 8.6 Asambleja e Pergjithshme merr vendime me shumice te zakonshme per:
  - Percaktimin e te drejtave dhe detyrave te Administratorit te Pergjithshem.
  - Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit te Pergjithshem
  - Percaktimin e shperblimeve per Administratorin, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar.
  - Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
  - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.



- Vendos nisjen e hetimeve te posacme lidhur me veprimtarine tregtare te Shoqerise.
- Nenshkrimin e marreveshjeve tregtare ndermjet Shoqerise dhe nje Ortaku te Shoqerise apo Administratorit te Pergjithshem.
- Nenshkrimin e marreveshjeve ndermjet Shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur Ortaku i njeres shoqeri eshte Ortak apo Administrator ne shoqerine tjeter.
- Nenshkrimin e kontratave afatgjata te cilat e ngarkojne Shoqerine me detyrime afatgjata, me shume se nje vit.
- Nenshkrimin e kontratave dhe marreveshjeve me palet e treta, per vlera qe i jane kufizuar Bordit Drejtues dhe Administratorit te Pergjithshem.
- Autorizimin dhe heqjen e te drejtes te personave qe urdherojne transferimin e fondeve te llogarive bankare te Shoqerise.
- Fillimin e procedimeve gjyqesore ndaj paleve te treta ne emer dhe per llogari te shoqerise.
- Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit te Pergjithshem.
- Shfuqizimin ne gjykate te vendimeve te Administratorit te Pergjithshem, kur keto perbejne shkelje te rende te ligjit ose Statutit.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme.
- Aprovimin e kompetencave shtese te Asamblese se Pergjithshme.
- Miratimin e Autorizimit te Posacem per shfuqizimin e ndalimit te permendur ne piken 1 te Nenit 17 te Ligjit per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo Statuti.

### **Neni 9 Votat e Ortakeve**

- 9.1 Ne perputhje me te drejttat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, cdo kuote i jep Ortakut te drejte votimi proporcionalisht me kapitalin e zoteruar.
- 9.2 Asnje Ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote, ne te kundert, vendimi i marre do te konsiderohet i pavlefshem.
- 9.3 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj, vlefshmeria e vendimeve, qe percaktojne detyrime shtese mbi Ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejttat e tyre, te parashikuara ne ligj ose ne Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut perkates.

### **Neni 10 Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme**

- 10.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga Ligji Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, nga ligje te tjera, nga dispozitat e Statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise.

Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

- 10.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori i Pergjithshem apo Ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit.
- 10.3 Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me poste elektronike duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe Ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese.
- 10.4 Kur Asambleja e Ortakeve nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe Ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.
- 10.5 Statuti apo Asambleja e Pergjithshme mund te percaktoje rregulla per procedurat e mbajtjes dhe pjesemarrjes ne mbledhjet e Asamblese. Keto rregulla miratohen nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te thjeshte.
- 10.6 Asambleja e Pergjithshme cakton nje Kryetar cili mund te jete njeri nga Ortaket ose nga Administratori i Pergjithshem.


#### **KREU IV ADMINISTRATORI I PERGJITHSHEM**

##### **Neni 11 Emerimi i Administratorit te Pergjithshem**

- 11.1 Asambleja e Pergjithshme emeron nje person fizik si Administrator te Shoqerise, sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 te Ligjit per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare. Emerimi i nenshtrohet individualisht nje vendimi te zakonshem i cili, nese miratohet, con ne zgjedhjen e personit te propozuar si Administrator.
- 11.2 Kufizimet ne lidhje me emerimin e Administratorit parashikohen ne Nenin 95 paragrafi (2) te Ligjit.
- 11.3 Shoqeria do te drejtohet nga Administratori si me poshte:
- Zoti Kolë Malaj, lindur me 17-11-1958, lindur ne Lekbibaj, Tropoje, banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 031744519. Kohezgjatja e funksionit te Administratorit eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), me te drejte ripertesitje te ketij mandati.

Zoti Kolë Malaj

Nënshkrimi



##### **Neni 12 Kompetencat e Administratorit te Pergjithshem**

- 12.1 Administratori i Pergjithshem detyrohet para Shoqerise te respektojte kufizimet e percaktuara me ligj dhe nga Statuti lidhur me hapesiren e autoritetit te tij menaxhues.





**12.2** Kompetencat e Administratorit te Pergjithshem jane:

- a. Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare dhe detyrat e vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b. Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- c. Pergatitit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- d. Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- e. Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- f. Raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare, detyrave dhe me realizimin e veprimeve te posaçme, me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

**Neni 13**

**Pergjegjesite e Administratorit te Pergjithshem**

- 13.1 Administratori i Pergjithshem eshte pergjegjes individualisht ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.
- 13.2 Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme ose Bordi i Drejtimit, ne varesi te kompetencave dhe qe i sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen Administratorit ose Ortakut qe ka bere marreveshjen, per t'i perballuar ne menyre individuale ose solidarisht, sipas rastit, pasojat perkatese.
- 13.3 Administratori i Pergjithshem detyrohet:
  - te kryeje detyrat e tij, te percaktuara ne ligj ose ne Statut, ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
  - te ushtroje kompetencat qe u njihen ne ligj ose ne Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
  - te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
  - te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
  - te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
1. Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje Administratorin e Pergjithshem ne cdo kohe, me shumice te zakonshme.

**KREU V  
AKTIVITETI I SHOQERISE**

**Neni 14**

## Viti ekonomiko-financiar

- 14.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon ne ditën e 31-t të muajit Dhjetor të secilit vit. Përfundimisht viti financiar korent fillon me regjistrimin e shoqërisë dhe përfundon ne datën 31 dhjetor 2020.

### Neni 15

#### Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

- 15.1 Fitimi i Shoqërisë përcaktohet ne baze të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja ne përputhje me Statutin, marrëveshjen e Ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.
- 15.2 Ne baze të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortaket vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:
- asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit;
  - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kerkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm;
- 15.3 Administratori i Përgjithshëm leshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkesat e pikës 15.2 me sipër. Nëse kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kritere, Administratori nuk mund ta leshojë këtë certifikatë.

## KREU VI

### MODIFIKIMI I FORMES LIGJORE; PRISHJA

#### Neni 16

##### Modifikimi i Formes Ligjore

- 16.1 Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblese së Përgjithshme, ne përputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 16.2 Shoqëria e re do të përbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit ne Shqipëri.

#### Neni 17


##### Prishja e Shoqërisë

- 17.1 Shoqëria mund të priset ne rrethanat e mëposhtme:
- si pasojë e përfundimit të kohezgjatjes për të cilin ishte themeluar;
  - me vendim të Asamblese së Ortakëve;
  - hapje e një procedure falimentimi/likuidimi;
  - me vendim gjykatë;
  - për arsye të tjera të parashikuara nga Ortaket, ne çdo kohë.

## KREU VII TE NDRYSHME

#### Neni 18

##### Largimi i Ortakut



18.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga Ligji per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare

**Neni 19  
Mosmarreshjet**

19.1 Mosmarreshjet qe mund te lindin nga interpretimi dhe zbatimi i ketij statuti do te zgjidhen me mirekuptim ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Neni 20  
Ligji i zbatueshem**

20.1 Kjo marreshje rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet shqiptare.

**Neni 21  
Te tjera**

21.1 Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete Statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Kodi Civil i Republikes se Shqiperise si dhe cdo ligj tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise .

**Nenshkrimi i Ortakeve**

DENI DEDA



Kole Malaj  
Malaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO)



DATE 29/06/2021  
NR REP 982

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 29/06/2021, para meje Notere HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, BLV "GJERGJ FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Kolë Malaj, atësia Pali, amësia Katerinë, shtetas Shqiptar, lindur në Lekbibaj, Tropojë dhe banues në Tiranë, me adresë Sami Frasheri; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 17/11/1958, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031744519 dhe nr. personal F81117028U , .

NËNSHKRUES/IT:

Deni Deda, atësia Ded, amësia Drita, shtetas Shqiptar, lindur në Lezhë dhe banues në LEZHË, me adresë 42 03170036; Nd. 35/1; H. 1; Zejmen; Spiten; 4510; Lezhë, lindur më 02/05/2003, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. BA9295675 dhe nr. personal K30502041F , .

Shtetasit e sipërdentifikuar u paraqiten personalisht përpara meje noterit, deklaruan se kane hartuar jashtë zyres noteriale dokumentin "**STATUT DHE AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE TREGETARE "EKO-GREEN" SHPK** bashkëlidhur, dhe e nenshkruajne me vullnet te lire dhe te plote rregullisht përpara meje noterit.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO)



*Helena Shëngjergji, Noter*